Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Developement

ANALIZA E TREGUT TË UJIT TË PIJËS TË AMBALAZHUAR

Prill, 2019

DEPARTAMENTI I ANALIZAVE EKONOMIKE DHE STATISTIKAVE BUJQËSORE

ANALIZA E TREGUT TË UJIT TË PIJËS TË AMBALAZHUAR

Prill, 2019

Parathënie

Burimet ujore si në çdo vend tjetër po ashtu edhe në Kosovë janë të një rëndësie jetike dhe duke pasur parasysh rolin strategjik të ujit kërkojnë trajtim të veçantë. Si burime të ujit të pijshëm janë burimet ujore sipërfaqësore dhe ato nëntokësore e që mund të themi se vendi ynë është mjaft i pasur me burime të ujërave nëntokësore dhe gjeotermale, prej nga vjen pjesa dërrmuese e ujit të pijshëm të ambalazhuar. Është një ndër produktet bazike dhe paraqitet me llojllojshmëri dhe çmim mjaft të volitshëm në treg. Në Kosovë prodhohen lloje të ndryshme të ujit natyral dhe mineral.

Duke parë rëndësinë dhe ndikimin e kësaj industrie në zhvillimin ekonomik të vendit, Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore në vazhdën e publikimeve të analizave të tregut ndër të tjera ka përfshirë edhe analizën e tregut të ujit të pijshëm të ambalazhuar. Përmes të dhënave statistikore në këtë analizë është prezantuar gjendja e prodhimtarisë vendore, eksportit dhe importit, bilancit tregtar, çmimeve për periudhën kohore 2010-2017, mbështetja e sektorit si dhe konkluzionet.

Tregu i ujit të pijes

Uji si burim i rëndësishëm natyror, si i tillë është i pazëvendësueshëm. Prandaj mirëmbajtja, menaxhimi dhe ruajtja e resurseve ujore si dhe ekosistemeve të ujit të freskët është me rëndësi jetike. Duke shfrytëzuar këto resurse ujore, viteve të fundit në vendin tonë, tregu i ujit të ambalazhuar ka pasur zhvillim të hovshëm si në tregun global ashtu edhe në tregun vendor. Ky zhvillim është si rezultat i investimeve private dhe mbështetjes nga donatorët. Progresi në këtë sektor u arrit përmes zgjerimit të gamës së produkteve, që u bë për të plotësuar kërkesat dhe preferencat e shumta të konsumatorëve të cilat më parë plotësoheshin nga produktet e importuara. Sipas statistikave nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, në vitin 2017, në vendin tonë janë të regjistruara 25 kompani të mëdha, të vogla dhe të mesme, që si aktivitet kryesor kanë prodhimin e ujit të pijshëm të ambalazhuar.

1 Prodhimtaria vendore

Sasia më e madhe e prodhimtarisë së ujit të ambalazhuar natyral dhe mineral vjen nga burimet e ujërave termale, prej nga fillon procesi i mbushjes në ambalazhë në sasi të ndryshme dhe kryesisht shitet si produkt i kontraktuar me shumicë në supermarkete, institucione të ndryshme dhe ato hoteliere. Ndërsa, një përqindje tjetër e prodhimtarisë është e orientuar për eksport, sasi kjo që është duke u rritur nga viti në vit. Falë profesionalizimit dhe linjës moderne të prodhimit, disa nga kompanitë e mëdha janë duke ofruar kualitetin dhe cilësinë e kërkuar në tregun ndërkombëtar. Me investime të shumta në fabrika, resurse njerzore dhe në rrjetin e distribuimit, viteve të fundit ekziston një linjë më e zgjeruar e produkteve, duke përfshirë ujin në shishe të qelqit dhe të plastikes në sasi prej 0.25 l, 0.75 l, 1 l, 1.5 l, 2 l dhe ujin në fuqi të mëdha të plastikës prej 5-10 dhe 19.5 l. Pa dyshim se zgjerimi i linjave të reja të prodhimit ka bërë të mundur përsosmërinë e produktit, përshtatjen e shpejtë ndaj nevojave të klientëve dhe zgjerimin e suksesshëm të kompanive. Kjo është një dëshmi që sektori privat është duke u avancuar me hapa të sigurt drejt prosperitetit ekonomik, ku krahas efekteve pozitive dhe sociale po kontribuojnë ndër të tjera edhe në krijimin e brendeve vendore të produkteve që janë duke u prodhuar kohëve të fundit në Kosovë.

2 Zhvillimi i tregtisë

Meqenëse prodhimtaria vendore është duke u rritur si rezultat i zgjerimit të kapaciteteve dhe aplikimit të teknologjisë moderne, sasia dhe cilësia viteve të fundit është rritur dukshëm. Për përmbushjen e kërkesave të popullatës për konsum me ujë të pijes të ambalazhuar, përveç prodhimit vendor një sasi e konsiderueshme e këtij produkti importohet, duke përfshirë lloje të ndryshme nga shumë vende të botës. Importi i këtij produkti në periudhën 2010-2016, mesatarisht ka qenë 104,165 tonë në vit, duke u shtuar varësisht nga kërkesat e tregut. Sasia më e madhe e importit ka qenë në vitin 2015, me 119,837 tonë, ndërsa në vitin 2017 kjo sasi ishte 112,988 tonë. Pas hulumtimit të kërkesave të tregut të jashtëm dhe në saje të aftësisë së disa kompanive për të depërtuar në tregjet jashtë vendit, një pjesë e prodhimtarisë është duke u eksportuar si në vendet e regjionit, të BE-së, si dhe në shumë vende të largëta në tregun botërorë siç janë: vendet Arabe, Afrikë dhe në Australi. Për sa i përket eksportit mesatarja e ujit të eksportuar për periudhën 2010-2016, ishte 12,700 tonë/vit, kurse në vitin 2017, kjo sasi arriti në 24,682 tonë, ku vërehet një rritje prej 94.3%, në krahasim me mesataren e viteve '10-16'. Sa i përket sasisë së ujit të eksportuar, si vit më i suksesshëm deri më tani ishte viti 2017. Nëse analizohet vlera e eksportit sipas muajve në vitin 2017, del se muaji Korrik është karakterizuar me vlerë më të madhe të eksportit, që ishte 1.3 mil. €, pasuar nga muaji Gusht 1.2 mil. € dhe muaji Maj 1.1 mil. €. Ndërsa, Janari ishte muaji me vlerë më të vogël apo 255 mijë €. Muajt tjerë kishin vlerë më tepër se sa Janari apo më pak se muaji Korrik.

Figura 1: Vlera dhe sasia e eksportit të ujit të ambalazhuar sipas muajve, në vitin 2017



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZHR

Sa i përket importit sasia më e madhe e ujit është importuar gjatë muajit Korrik me 3,762 tonë, pasuar nga muaji Maj 2,762 tonë, muaji Qershor me sasi prej 2,587 tonë si dhe në muajin Gusht, me sasi 2,428 tonë.

Sasia më e vogël e ujit është importuar në muajin Janar të vitit 2017, ku janë importuar vetëm 645 tonë.

2.1 Importi i ujit të pijes të ambalazhuar

Sasia e ujit të importuar ka pasur rënie dhe ngritje nga viti në vit, varësisht nga disponueshmëria e prodhimit vendor dhe kërkesat e tregut. Gjatë analizimit të importit, viti 2011 dhe 2012 paraqiten si vite me sasi më të vogël të importuar (996 mijë tonë), ndërsa sasi më të madhe ka pasur në vitin 2015 në sasi prej 119,837 tonë. Nëse krahasojmë sasinë e importit në vitin 2017 (112,988 tonë) me sasinë më të lartë të importit për këto vite që ishte në vitin 2015, rrjedh se në vitin e fundit paraqitet rënie e sasisë së ujit të importuar për 5.7%.

Figura 2: Importi i ujit të ambalazhuar për vitet 2010-2017, vlera (në 1000 €), sasia (në tonë)



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZHR

Vlera mesatare e importit për periudhën '10-'16, ishte 43.7 mil. €, vlerë e cila është e përafërt me vlerën e importit të vitit 2017, që ishte 45.4 mil. €, e që për dallim nga mesatarja e viteve '10-'16, paraqitet me rritje prej 3.9%. Vlera më e lartë e importit të ujit të pijes në periudhën kohore '10-'17, ishte në vitin 2015, e cila kishte vlerën 46.2 mil.€.

Vendet prej nga është importuar sasia e ujit në vitin 2017, vërejmë se më së shumti është importuar nga Serbia me pjesëmarrje në sasinë e importit prej 75%, pasuar nga Shqipëria 11%, Turqia 4%, Kroacia 2% dhe Sllovenia 1%. Këto vende përbëjnë 93% të importit, ndërsa vendet të grupuara si të tjera marrin pjesë më vetëm 7%.

Figura 3: Sasia importit të ujit të pijes të ambalazhuar, sipas vendeve, në vitin 2017 (%)



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZHR

Sa i përket vlerës së importit në figurën në figurën 4, është paraqitur pjesëmarrja e shteteve në vitin 2017. Me pjesëmarrje më të madhe në import ishte Serbia me 66%, pasuar nga Shqipëria 5%, Turqia 6%, Kroacia dhe Sllovenia që kishin pjesëmarrje të njejtë prej 2%, dhe Maqedonia 1%, ndërsa vendet të grupuara si "Të tjera" kishin një pjesëmarrje prej 18%.

Figura 4: Vlera e importit të ujit të pijes të ambalazhuar, sipas vendeve, në vitin 2017 (%)



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZHR

2.2 Eksporti i ujit të pijes së ambalazhuar

Vlera më e lartë e eksportit të ujit të freskët është arritur në vitin 2017, në vlerë prej 10.1 mil. €, e që edhe sasia e këtij produkti ishte më e lartë. Në anen tjetër vlera sasia më e ulët ishte në vitin 2010, me vetëm 2.3 mil. €. Vlera e eksportit të ujit në vitin 2017, krahasuar me vlerën e vitit 2016, kishte rritje prej 83.9%.

Figura 5: Eksporti i ujit të pijes të ambalazhuar 2010-2017, vlera në 1000 €, sasia në tonë



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZHR

Sa i përket eksportit sipas vendeve, përqindja më e lartë e ujit ishte eksportuar në Maqedoni 31%, pastaj Shqipëri 17%, Bullgari 10%, Rumani 7%, Mali i Zi 6%, Zvicër 4%, pasuar nga Serbia dhe Italia që kishin pjesëmarrje prej 2%, si dhe në shtetet e grupuara si "Të tjera" 21%.

Figura 6: Vlera e eksportit të ujit të pijes të ambalazhuar, sipas vendeve, në vitin 2017 (%)



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZHR

2.3 Bilanci tregtar për ujin e pijes të ambalazhuar

Bilanci tregtar për ujin e pijes të ambalazhuar në periudhën '10-'17, kishte vlerë mesatare negative prej 37.7 mil. €. Nga vitet e prezantuara në figurën 7, vërejmë se vlera negative më e lartë e bilancit tregtar ka qenë në vitin 2011 (-39.7 mil. €), ndërsa vlera më e ulët negative e bilancit tregtar ishte në vitin 2017, (-35.2 mil. €). Sa i përket mbulueshmërisë së importit me eksport për periudhën '10-'16 mesatarisht kjo përqindje ishte 12.9%. Në vitin 2017, përqindja e mbulueshmëris së importit me eksportit ishte 22.4% apo 9.5 pikë % më tepër se sa mesatarja e viteve '10-'16.

Figura 7: Bilancit tregtar për ujin e pijes të ambalazhuar, në 1000 €



Burimi: ASK përpunuar nga DAESB – MBPZHR

3 Çmimi i tregut

Plasimi i ujit në treg nuk paraqet ndonjë problem të madh për kompanitë prodhuese të ujërave, nga vet fakti se kohët e fundit tregu i ujit të pijes në vendin tonë është një treg për të cilin ka një kërkesë mjaft të madhe. Kështu që prodhimi vendor i ujit të pijshëm është mjaft i përhapur dhe gjendet në treg në forma dhe sasi të ndryshme, gjithashtu edhe uji i importuar nga shtetet e ndryshme është shumë i pranishëm gjatë gjithë vitit.

3.1 Çmimi i importit

Uji i pijes i ambalazhuar në Kosovë importohet gjatë tërë vitit, por gjatë muajve të verës rritet sasia e importit për shkak të temperaturave më të larta, me ç'rast shtohet edhe konsumi i sasisë së ujit që vjen nga importi. Çmimet e importit të ujit janë të ndryshme varësisht nga kompanitë furnizuese. Duke filluar nga çmimet më të larta 0.89 €/l e deri në 0.22 €/0.5 l. Zakonisht uji në ambalazh të qelqit ka çmim më të lartë qoftë prodhim vendor apo nga importi.

3.2 Çmimet në tregun vendor

Uji i pijshëm i ambalazhuar si prodhim vendor në treg paraqitet me çmime të ndryshme. Disa nga kompanitë prodhuese kohëve të fundit sipas kërkesës së tregut kanë filluar të përdorin edhe ambalazhin prej qelqi, gjë që njëherit edhe e ngrit çmimin e produktit, krahasuar me ato të plastikës. Çmimi mesatar i ujit të ambalazhuar në fuçi prej 10 l sillej prej 1.5 €/l. Kompleti prej 6 copë nga 1.5 l ujë natyral 1.6 €, ndërsa ai nga 12 copë në sasi prej 0.5 l ishte 2.4 €. Sa i përket çmimeve me pakicë të ujit në shishe nga plastika në sasi prej 1.5 l, çmimi mesatar arriti në 0.34 €. Me çmim më të lartë karakterizohet uji në shishe prej qelqi, kështu që prodhimi vendor është karakterizuar me çmim mesatar prej 0.40-0.45 €/l, ndërsa çmimi mesatar për ujin prej 1.5 l, në ambalazh të plastikës ka qenë 0.50 €. Ujërat në sasi prej 0.5 l kanë pasur çmim mesatar 0.17- 0.25 €. Kur bëhet fjalë për çmimet me shumicë mund të thuhet se këto ishin 5% më të ulëta në krahasim me ato me pakicë. Në figurën në vijim është paraqitur çmimi i ujit mineral për periudhën '02-'17, që paraqitet me një mesatare të çmimit prej 0.36 €/1.5 l. Për këtë periudhë kohore vërehen luhatje të vogla të çmimit, ku mund të themi se çmimi më i ulët ka qenë në vitin 2016 me 0.30 €/1.5 l, kurse ai më i lartë ishte në vitin 2004 e që arriti në 0.43 €/1.5 l.

Figura 8: Çmimi mesatar vjetor i ujit mineral, për vitet 2002 - 2017, €/1.5 l



Burimi:ASK përpunuar nga DAESB – MBPZHR

4 Madhësia e tregut

Sipas statistikave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, rrjedh se tregu i përgjithshëm i ujit në Kosovë në vitin 2017, vlerësohet të jetë rreth 64.6 mil. €. Kjo përfshinë vlerën e gjithë prodhimtarisë vendore (19.2 mil. €) si dhe importin (45.4 mil. €). Vlera e prodhimit vendor të ujit të ambalazhuar në vitin 2017, ka pjesëmarrje prej 29.8%, në tregun e kësaj industrie, ndërsa vlera e ujit të importuar merr pjesë me 70.2%.

5 Mbështetja e prodhimtarisë së ujit

Sektori privat konkretisht kompanitë e industrisë së ujit të pijes në formë të ambalazhuar, aktualisht konsiderohen si një ndër degët e rëndësishme të zhvillimit ekonomik. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), ofron përkrahje përmes Skemës Voucher të këshillëdhënies, që nënkupton ofrimin e këshillimeve duke mundësuar subvencionimin e një pjese të këshillimeve për biznese, në fushat me interes për ndërmarrjet; Dialogut publiko-privat përmes aktiviteteve të "Ditëve të Biznesit të Vogël", që ka të bëj me organizimin e konferencave me biznes në 7 rajonet e Kosovës. Qëllimi i konferencave është të paraqiten dhe diskutohen sfidat e sektorit privat si dhe shërbimet dhe programet zhvillimore që ofrohen nga Qeveria në nivel qendror dhe lokal. Përmes marrëveshjes së MSA[1], Kosovës i është dhënë qasje e plotë dhe pa tarifa doganore për eksportet në tregun e BE-së, përveç për një numër të limituar të produkteve për të cilat aplikohet regjimi i kuotës. Për të ndihmuar bizneset që dëshirojnë të eksportojnë në tregun mbi 500 milionësh të BE-së, Komisioni Evropian ka krijuar një helpdesk online ku mund të gjenden të gjitha informatat për procedurat për eksport në BE (Tarifat, Rregullat e origjinës, Standardet e sigurisë apo teknike dhe shëndetësore, Dokumentacioni i kërkuar për dërgesa dhe Tatimet e brendshme (TVSH) për 28 vendet anëtare të BE-së).

Në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), ekziston Sektori për promovimin e eksportit. Ky sektor ka për qëllim krijimin e një shërbimi më të mirë për bizneset kosovare dhe plasimin e produkteve jashtë vendit dhe për rrjedhojë rritjen e eksporteve. Sektori i eksporteve ofron shërbimet përkatëse në këtë drejtim, siç janë: Bashkëpunimi me kompanitë eksportuese, asociacionet e bizneseve, institucionet donatore, operatorët turistikë për bashkërenditje të aktiviteteve që ndërlidhen me aktivitetet e sektorit për promovim të eksportit; Mbajtjen e bazës së të dhënave për kompanitë eksportuese; Ndihmon kompanitë eksportuese të plasojnë mallrat e tyre në tregjet ndërkombëtare. Gjithashtu koordinon punët ndërinstitucionale lidhur me çështjet e promovimit të kompanive eksportuese dhe operatorëve turistik; Mbështet organizimin e panaireve brenda dhe jashtë vendit; Organizon seminare dhe takime studimore për plotësim të kërkesave të tregjeve të jashtme; Bashkëpunon me shoqatat e biznesit për zhvillimin e politikave promocionale dhe iniciativave për eksport si dhe aktiviteteve tjera.

[1]Marrëveshja e Stabilizim Asocimit e viti 2016

6 Promovimi dhe sfidat

Vite me radhë në Kosovë, Agjencia për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve-KIESA pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, organizon panaire për promovimin e bizneseve të ndryshme, në këtë rast edhe bizneset që prodhojnë ujë të ambalazhuar janë shumë të pranishme me llojllojshmërinë e produkteve të tyre. Këto panaire të cilat tani kanë një karakter nacional dhe regjional, po ndikojnë në sensibilizimin e opinionit për prodhimtarin vendore të ujit të pijes dhe llojin e produkteve që ofrojnë kompanitë vendore si dhe në promovimin e konsumimit të produkteve vendore. Duhet të përmendet se, organizuar nga Shoqata Botërore e Ujit të pijes tri kompani të mëdha kosovare janë shpërblyer për kualitet të ujit dhe për ambalazhim të bukur[2]: në "International Quality Award[3]", në "World of Premium Waters[4]", "Business Initiative Directions" me çmimin platin ERA në kategorinë "Çmime ndërkombëtare për cilësi". Kualiteti dhe cilësia e lartë ka mundësuar që uji i dy kompanive të shitet në Zvicër në 500 dyqane të rrjetit ushqimor "Coop'', që i kanë pasuruar raftet e tyre me produkte kosovare.

Po ashtu njëra nga këto kompani furnizon me ujë bazën e ushtrisë Amerikane në Kosovë, Bullgari, Rumani, Gjermani, Hungari, Kroaci, Slloveni, ambasadat e huaja si dhe shumë institucione të jashtme e vendore.

Uji i prodhuar në vendin tonë ka gjetur vend edhe në disa supermarkete në vende tjera Evropiane, në përgjithësi aty ku jetojnë bashkëkombësit tanë. Pengesat kryesore në mjedisin e të bërit biznes në këtë sektor ndër më kryesoret mund ti përmendim: mungesa dhe kosto e lartë e energjisë elektrike, shkalla e lartë e tatimeve, qasja në kredi, korrupsioni, mungesa e fuqisë blerëse në tregjet vendore, mungesa e puntorëve të kualifikuar, mungesa e të diplomuarve të specializuar, vështirësitë në plasimin e produkteve jashtë vendit sidomos në vendet që nuk e kanë njohur Kosovën, kostot e larta të punonjësve të kualifikuar si dhe disa vështirësi tjera.

---

[2] http://www.finewaters.com/bottled-waters-of-the-world/kosovo

[3] http://www.wqa.org/awards

[4] http://premiumwaters.co.ke/index.php/lighting-design

7 Konkluzionet

Nga të dhënat e paraqitura në këtë analizë, mund të konkludojmë se në Kosovë ky sektor është në rritje e sipër dhe se është duke u zgjeruar me hapa të shpejtë. Kjo rritje ka ardhë duke u bazuar në kërkesat e tregut qoftë vendor po ashtu edhe ndërkombëtarë. Mund të konkludojmë se uji i pijes i ambalazhuar po paraqitet si njëri ndër produktet me potencial të lartë të eksportit në vende të ndryshme të botës, duke punësuar më tepër se 500 punëtor të rregullt vendor në procesin e prodhimit dhe shumë të tjerë që lidhen me zingjirin e prodhimit në këtë industri. Përkrahja për bizneset që vjen nga Sektori për promovimin e eksportit i cili gjendet në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë duhet të jetë më i madh për shkak të rëndësisë së madhe që ka kjo degë e industrisë. Prandaj, vlerësojmë se duhet të rishqyrtohen masat e përkrahjes së deri tanishme nga MTI, që do të ndihmonte në përmirësimin e teknologjisë, përmes së cilës mund të arrihen standarde të larta të produktit - ujit edhe në kompani tjera ekzistuese në Kosovë. Kjo përkrahje duhet të rritet me qëllim të shtimit të mëtutjeshëm të kapaciteteve prodhuese dhe zëvendësimin e teknologjisë së vjetër me atë moderne. Arritja e standardeve do t'i bënte kompanitë Kosovare konkurrente si në tregun vendor poashtu edhe në tregun e jashtëm.